

Shërbimi
Seancës Plenare
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. 3039 Prot.

Tiranë, më 22. 10. 2025

Lënda:
Blendi Gonxhja.

Kërkesë për interpelancë me ministrin e Kulturës, Turizmit dhe Sportit Z.

Drejtuar:
Z. Niko PELESHI
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

Këtu

Z. Kryetar,

Projekti “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID në Durrës”, i financuar nga qeveria shqiptare, Bashkia e Durrësit dhe Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), parashikon ndërhyrje të thella në zemër të qytetit historik të Durrësit, përmes modelit të ashtuquajtur të investimeve të integruara transformuese (TID). Ky projekt, ndonëse prezantohet si iniciativë për “rijetëzim turistik”, ka ngritur shqetësime serioze në lidhje me ndikimin e tij mbi banorët aktualë të zonës, trashëgiminë kulturore, si dhe mënyrën e zhvillimit të tij dhe inpaktin real në turizëm.

Sipas të dhënave publike dhe raportimeve mediatike, mbi 70 familjeve që jetojnë në zonën ku parashikohet zbatimi i projektit u është kërkuar të largohen, duke hyrë në një proces shpronësimi, me qëllim lirin e hapësirave për ndërhyrjet që parashikon projekti TID. Këta banorë janë pronarë të ligjshëm, që kanë trashëguar apo përfituar pasuritë në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Zbatimi i projektit, në formën aktuale, ngre një sërë pikëpyetjesh të natyrës kushtetuese, ligjore, sociale dhe ekonomike, të cilat lidhen me:

- 1- Transparençën dhe konsultimin me komunitetin përfitues dhe të prekur;
- 2- Raportin e projektit me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe me legjislacionin për trashëgiminë kulturore;

- 3- Vlerësimin real të ndikimit në turizëm në raport me dëmtimin e strukturës historike dhe sociale të qytetit;
- 4- Procesin e shpronësimeve dhe dëmshpërblimeve për banorët, si dhe garancitë për të drejtat e tyre pronësore.

Ky projekt, i vendosur në një nga qytetet më të rëndësishme historike dhe turistike të Shqipërisë, duhet të jetë objekt i transparencës së plotë dhe llogaridhënies publike. Sepse deri tani ngjan me abuzim me interesin publik për interesa klientelistëve të fondacioneve private. Ne kemi për detyrë të garantojmë që zhvillimi turistik të jetë i qëndrueshëm, real dhe mos të dëmtojë trashëgiminë e atij qyteti, historinë dhe identitetin e tij dhe komunitetit lokal.

Në funksion të së drejtës kushtetuese për informim dhe kontroll parlamentar mbi ekzekutivin, si dhe në përputhje me: nenin 80, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 96, pikat 1 dhe 2 të Rregullores së Kuvendit,

Kërkoj zhvillimin e një interpelance me Ministrin e Kulturës, Turizmit dhe Sportit, z. Blendi Gonxhja, *për të marrë sqarime lidhur me projektin TID në Durrës, ndikimin e tij në zhvillimin e turizmit, trashëgiminë kulturore dhe mbi të gjitha për pasojat që ai sjell për pronarët dhe banorët e zonës së prekur.*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

DEPUTETE

Ina ZHUPA

